

PROÇESVERBAL

Proçesverbal i konsultimit publik me bizneset/bujqësinë lidhur me buxhetimin me pjesëmarrje, i mbajtur më datë **14.11.24** ora 10:00 në Njësinë Administrative Shirgjan, fabrika e vajit të ullirit, ku marrin pjesë kryetari i bashkisë Z. Gledjan Llatja, Administrator i Njësisë Administrative Shirgjan, fermerë sipërmarrës dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak, gjithsej 54 pjesëmarrës.

Z. Gledjan Llatja: Është hera e dytë që ne mbidhemi në këtë ambjent të rikonstruktuar rishtazi për të dëgjuar fermerët, për të diskutuar për cështjet e bujqësisë dhe për të parashikuar në 2024 ato invenstime që janë të nevojshme, të domosdoshme por dhe që mbështesin fermerët. Kanalet kulluese, kanalet vaditëse, uanaza bujqësore. Për të shkuar tek krijimi i Grupit Vendor Bujqësor që është organizimi i parë në formën e një organizimi federativ për të bërë politikat bujqësore për Bashkinë e Elbasanit edhe pas këtij zhvillimi që ne bëm vjet. Pas dëgjesave publike që bëm me të gjithë fermerët dhe njësitë administrative ishin të gjithë të idësë se duhej krijuar një agjensi që të ishte dhe ajo për mbështetjen specifike për bujqësinë, për veterinarinë, për mjedisin. Ne sot kemi një agjensi të re e cila është fokusuar vetëm tek çështjet e mjedisit, bujqësisë dhe veterinarisë. Unë e kam pasur fokus kryesor bujqësinë dhe shifrat kanë treguar që kemi qënë efikas në pastrimin e kanaleve kjo ka sjell rritje të prodhimit. Kemi qënë efikas për sa i përket mbështetjhes së fermerëve dhe për garancinë, për punimin e tokës të atyre që i kishin mbjell me pemtari që më vonë është përkthyer edhe ne një ligj të posacëm. Kemi qënë mbështetje të unazës bujqësore e cila na është përkthyer me rritjen e sipërfaqeve të serave..

Sipërmarrës: Një problem që ne kemi janë tarifat. Ju na keni ndihmuar por kërkesa ime është ulje e tarifës së plehrave.

Z. Gledjan Llatja Një sërë punësh të cilat i kemi bërë bashkë, i kemi dikskutuar kur ju i keni kërkuar. Jemi përpjekur të bëjmë maksimumin. Ne këtë vit po bëjmë politika fiskale shumë të mira. Po mbështesim ato që ne i kemi potenciale kryesore si për shembull në Gjinar, në Funarë duam të mbështesim të rinxjtë atje që duan të hapin një biznes me mbështetje të drejtpërdrejtë financiare

Kërkesa të dala nga konsultimi publik gjatë diskutimeve me sipërmarrës fermërë dhe banorë:

- Problem trualli tek Federata Bujqësore.

- Pikë grumbullimi e cila të menaxhohet nga bashkia ku i shërben Jagodinës dhe fshatrave përreth për serat dhe prodhimin.
- Shirgjan, azhornimi tokës për mbjellje fruta perime. (kivit)